

**KËRKESË PËR DEBAT PUBLIK ME KRYETARIN E AGJENSISË PRONAVE Z. ELVIS ÇEFA  
A DO TI MBANI MË PENG PRONARËT ZOTI ÇEFA**

Pronarët e zonave turistike me 31.07.2012 u informuan me prononcimin në media të Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së, Elvis Çefa se në Janar 2013 do të nisi skema e re e kompensimit financiar etj. Vendimi unifikues i dt 31.07.2012 i Gjykatës së Strasburgut që detyron Shtetin Shqiptar të paguaj 2.994.000 euro për të kompensuar katër pronarë, me pak vonesë tregoi qartë se shteti Shqiptar është në rrugë të gabuar.

Shoqata Bregdeti me dhjetra herë ka deklaruar se zëvendësimi i kthimit fizik me kompensim i çfarëdo lloji qoftë ai, për prona që duhet të kthehen tek i zoti është rrugë e gabuar dhe tentativë për të maskuar vjedhjen e trojeve turistike. Nëse zbatohet Kushtetuta dhe rruga e zgjidhjes që ofrojnë shoqatat zgjidhja e problemit të pronës bëhet pa faturë financiare, ose me faturëminimale, por deri sot vullneti politik ka qenë negative. Praktikisht Agjensia e pronave ka funksionuar si institucion që ka penguar kthimin fizik të pronave në zonat turistike. Në këto 20 vjet shtet pluralist dhe demokratik, politika e gabuar me pronat, ka pasur mbështetjen e ndërkombëtarëve, të B.Botërore dhe FMN dhe prandaj pushteti është transformuar në mekanizëm me të cilin pushtetarët të pasurojnë veten dhe klanin që i mbështet dhe kjo ka gjeneruar konflikte të shumta. Me këtë oligarki politikanësh, pa ideal kombëtar dhe shumë larg me parimet e demokracisë, populli lëngon. Një hallkë e zbatimit të kësaj platforme çnjerëzore ka qenë Agjensia e pronave nëpërmjet bllokimit të kthimit fizik. Zoti Elvis Çefa , ka përgjegjësinë e tij personale për mos zbatimin e ligjit në fuqi. Mjafton fakti se Agjensia i ka mbajtur peng për disa vjet pronarët dhe nuk ka respektuar afatin një mujor që përcakton ligji 9235. Në këto vjet që Z. Çefa ka qenë në drejtim të Agjensisë le të publikojë numurin dhe emrat e pronarëve që ku ka kthyer pronat në Bregdet, por ai e di mire se sa shumë e ka shkelur të drejtën e pronarëve.

Ndërkombëtarët dhe politikanët shqiptarë mbyllin veshët dhe sytë para ankesave tona qytetare se Agjensia po krijon mbivendosje dhe konflikte pasi ndërkohë që pronarët mbahen peng, personat e tretë që pushtojnë dhe ndërtojnë pa leje bëhen pronarë për 45 ditë. Ne ankohe mi se anarkia e pronës dhe zbatimi i standardeve të dyfishta brenda të njëjtit shtet po merr jetë njerëzish, se korrupsioni po zhvillohet nga lart poshtë dhe ka prekur si administratën dhe drejtësinë, se po nuk u respektua e drejta e shtetasve për të gëzuar pronën e tyre të trashëguar, shkelen të drejtat e njeriut , nuk funksionon demokracia dhe nuk funksionon shteti ligjor

Liritë dhe të drejtat e njeriut, e drejta e pronës së trashëguar njihen teorikisht por në fakt shkelen nga vetë shteti përfshi dhe Agjensisë e pronave. Zoti Çefa e di mirë se pronarët e zona turistike, po përballen më shumë se kushdo me arbitraritetin shtetëror mbi pronën e tyre të trashëguar, se qeveritarët dhe politikanët vjedhin pronat turistike në emër të ligjeve që vetë i miratojnë dhe i ndryshojnë sipas interesave dhe kërkojnë të justifikohen me kompensim.

Nisur nga fakti se pas disa vjet drejtor i përgjithshëm i AKKP zoti Çefa mund të bëhet zv kryetar i KLD, kemi edhe me teper shkak dhe arsye të bëjmë këtë debat dhe jemi në pritje të përgjigjes publike

Kryesia e Shoqatës “Bregdeti”